REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.1,datë 29.01.2026, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin dhjetor 2026".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022; Udhëzimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 6 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projekti synon përdorimin e fondeve të kushtëzuara për ndihmë ekonomike mujore deri në 6% të buxhetit vendor, për muajin dhjetor 2025. Një total prej 20 familjeve do të përfitojnë një ndihmë totale prej 73,267 lekë, e shpërndarë si më poshtë:

· Për Bashkinë Sarandë: 19 familje me një fond total prej 67,386 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 1 familje me një fond prej 5,881 lekë.

Kjo ndihmë i shërben familjeve në gjendje të vështirë ekonomike, në përputhje me kriteret e miratuara nga bashkia.
Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shpenzimet parashikohen në kuadër të fondit të kushtëzuar për ndihmë ekonomike, brenda kufirit të 6% të buxhetit vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shuma totale prej 73,267 lekë do të shpërndahet në bazë të listës së miratuar.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, do të monitorojë shpërndarjen e fondeve dhe do të raportojë për përdorimin e tyre në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Impakti social / grupet që preken:

20 familje në gjendje të vështirë ekonomike në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit.

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.2,datë 29.01.2026, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 6 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr. 73 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2025".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti synon shpërndarjen e ndihmës ekonomike për muajin dhjetor 2025, nga të ardhurat e bashkisë, për 52 familje në total, me një fond prej 215,769 lekë. Shpërndarja bëhet si më poshtë:

· Për Qendrën e Bashkisë Sarandë: 41 familje me 157,359 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 11 familje me 58,410 lekë.

Projekti përcakton edhe përjashtimin e disa familjeve nga kjo skemë për arsye të përmirësimit të gjendjes ekonomike (përmes punësimit) ose për shkak se ato përfitojnë tashmë nga skema e ndihmës 6% për bllok-ndihmën ekonomike.Njëkohësisht,përfshihen 5 familje të reja në Bashkinë Sarandë dhe 1 familje në Ksamil.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Shuma totale prej 215,769 lekë parashikohet të shpenzohet nga të ardhurat e bashkisë, në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2025 dhe kriteret për ndihmën ekonomike.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A
Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e fondeve dhe do të raportojë për përdorimin e tyre, duke u siguruar që ndihma i shkon familjeve që plotësojnë kriteret.

Impakti social / grupet që preken:

52 familje në gjendje të vështirë ekonomike në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, duke përfshirë kryefamiljare gra pensioniste dhe familje me probleme sociale.

A është objekt i konsultimit publik?
Jo.
Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit.

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.4,datë 29.01.2026, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencionimit të qirasë në tregun e lirë".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 8, 9 dhe 24; Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2023; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; Vendimin e Komisionit të Strehimit nr. 1 datë 15.01.2024; dhe Udhëzimin nr. 31 datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projekti synon miratimin e listës së 40 familjeve të përzgjedhura për të përfituar nga programi i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë. Kjo ndihmë sociale synon të lehtësojë familjet e paafta financiarisht për të përballuar qiranë e strehimit në tregun e lirë.

Përzgjedhja është bërë nga Drejtoria e Kujdesit Social në bashkëpunim me Komisionin e Strehimit, duke përdorur sistemin e pikëzimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 121 datë 29.09.2025. Në total janë marrë 42 aplikime, nga të cilat janë miratuar 40.

Grupet e përfshira përfshijnë: persona me aftësi të kufizuara, përfitues të ndihmës ekonomike, përfaqësues të minoriteteve rom dhe egjiptian, familje njëprindërore, të moshuar, gra kryefamiljare, familje me më shumë se 4 fëmijë, familje të reja, dhe vajza nënë.
Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Kostoja totale e programit për 40 familje është 7,055,602 lekë.
Financimi është i përzier:

· Deri në 50% financohet nga Buxheti i Shtetit (përmes Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë)
· 50% mbulohet nga fondet e Bashkisë Sarandë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e subvencionimeve dhe do të raportojë për përdorimin e fondeve në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Ministria dhe buxheti i shtetit.

Impakti social / grupet që preken:

40 familje me të ardhura të ulëta ose shumë të ulëta, që kanë vështirësi në strehim, përfshirë grupe të ndjeshme sociale si persona me aftësi të kufizuara, minoritete, familje njëprindërore dhe gra kryefamiljare.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit.

Laureta Ceci _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.5,datë 29.01.2026, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që do të përfitojnë bursat financiare për vitin shkollor 2025-2026".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; neni 19 të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike"; Shkresën nr. 7094 prot. datë 06.11.2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; dhe Shkresën nr. 973/1 prot. datë 29.10.2025 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projekti synon miratimin e listës së nxënësve të cilët do të përfitojnë bursa financiare për vitin shkollor 2025-2026 në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në Bashkinë Sarandë. Bursat shpërndahen në bazë të tre grupeve kryesore të kritereve:

1. Kriteri ekonomik – për nxënës nga zona rurale, me largësi më shumë se 5 km, që banojnë në konvikte publike dhe kanë vështirësi ekonomike.
2. Kriteri i rezultateve të arritura – për nxënës të arsimit profesional me notë mesatare 9–10.
3. Kriteri jookonomik – për nxënës në situata të veçanta sociale (jetimë, aftësi të kufizuara, pakicë rome dhe egjiptiane, vajza në drejtime teknike, etj.).

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Bursat financohen nga buxheti shtetëror dhe/ose vendor, në përputhje me kuotat e caktuara nga ministritë përkatëse. Shpenzimet për bursa janë të parashikuara në buxhetin e arsimit për vitin shkollor 2025-2026.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financave.
Mbështetje ligjore dhe financiare: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financave.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar do të monitorojë shpërndarjen e bursave dhe do të raportojë për përdorimin e fondeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet e ministrive përkatëse.

Impakti social / grupet që preken:

Nxënësit e arsimit parauniversitar nga Bashkia Sarandë që ndodhen në kushte ekonomike ose sociale të vështira, si dhe nxënësit me rezultate të shkëlqyera akademike. Bursat synojnë të lehtësojnë qasjen në arsim dhe të promovojë barazinë e mundësive.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit.

__ Ermir Hoxha_____ Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

__Zana Piro_____ sekretare e Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.6,datë 29.01.2026, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e përdorimit dhe planin e shpërndarjes së fondit të grantit të bazuar në performancë të bashkive për vitin 2025".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 01 datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjes e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Sarandë ka aplikuar dhe është përzgjedhur si fituese e Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025, me një vlerë totale prej 7,034,893.57 lekë, e ndarë në dy burime financimi:

· Burim nga Buxheti i Shtetit: 3,146,067.40 lekë
· Burim nga financimi i huaj (SDC dhe SIDA): 3,888,826.16 lekë

Granti është një mekanizëm konkurrues që financon bashkitë bazuar në përmbushjen e treguesve të performancës në fusha të ndryshme të qeverisjes vendore.

Ky projektvendim synon miratimin e përdorimit dhe planit të shpërndarjes së fondit, duke respektuar udhëzimet dhe kriteret e përcaktuara nga autoritetet qendrore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Fondi i grantit nuk është pjesë e buxhetit të rregullt vendor, por është një burim shtesë i finanimit. Shpërndarja e tij do të bëhet sipas planit të miratuar dhe në përputhje me qëllimet e projektit dhe prioritetet e bashkisë, kryesisht në fushën e arsimit dhe të shërbimeve sociale.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Koordinimi i përgjithshëm: Drejtoria e Projektave, Turizmit dhe Integrimit Europian.
Zbatimi në fusha specifike: Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Kujdesit Social.
Mbështetje ligjore dhe financiare: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financave.

Monitorimi dhe raportimi:

Bashkia Sarandë do të ndjekë procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 01/2025 dhe do të raportojë rregullisht për përdorimin e fondeve dhe arritjen e treguesve të performancës, në përputhje me kërkesat e donatorëve dhe autoriteteve vendore.

Impakti social / grupet që preken:

Qytetarët e Sarandës në përgjithësi, përmes përmirësimit të shërbimeve publike, veçanërisht në fushën e arsimit dhe të kujdesit social.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit.

__Ermir Hoxha_____ Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)
__Zana Piro_____ sekretare e Komisionit
(emri, mbiemri, firma)